

VENDIM
Nr. 136/2019

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 90/2017, “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 17/1, pika 1, 21, pika 2, dhe 55, pikat 2 e 3, të Rregullores së Kuvendit, me kërkesë të vetë deputetëve propozues dhe miratimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Deputeti Erion Piciri (deputet jashtë grupeve parlamentare) caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

2. Deputeti Edmond Stojku (deputet jashtë grupeve parlamentare) caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 11.11.2019